



**VENDIM**

*Nr. 54 Datë 03.08.2009*

**PËR  
LICENSIMIN E SHOQËRISË “EFT ALBANIA” SH.P.K NË  
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR TE  
ENERGJISE ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, 9, 13, pika 1, gërma “ç”, dhe nenit 45 pikat 3, 4, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, gërma “P”; 5; 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 03.08.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k për liçensim në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

**Dhe Konstatohet se :**

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k ka nisur me marrjen e vendimit Nr. 35, dt.07.05.2009.
- Dokumentacioni për aplikimin për liçensimin për kryerjen e aktivitetit të Furnizuesit të Kualifikuar të energjisë elektrike është paraqitur i plotë konform përcaktimeve të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të liçensoje shoqërinë “EFT Albania” sh.p.k. në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të energjisë elektrike me afat të vlefshmerise se liçensave 5 vjet.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

*VENDIMIN*

*Nr. 54 Datë 03.08.2009*

**PËR  
LICENSIMIN E SHOQËRISË “EFT ALBANIA” SH.P.K NË  
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR TE  
ENERGJISE ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____